

AKTI I THEMELIMIT

DHE STATUTI

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“SOURCE ALBANIA” shpk**

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "SOURCE ALBANIA" shpk

Sot me date **01.09.2025** ne Tirane, personi me te dhënat si me poshtë:

Z. Baton Haxhiu, I biri I Fazli, I dtl.24.02.1965, lindur ne Paklek, Kosove dhe banues ne Kavaje me adresën Kompleksi "Laguna Blu" Qerret, Kavaje, Tirane shtetas shqiptar madhor dhe me zotësi juridike dhe për te vepruar, majtës I Letërnjoftimi nr: 03716603 dhe me nr. Personal G50224055F mëposhtëm referuar si themelues,

Duke vepruar ne cilësinë e Ortakut te Vetëm Themelues, vendosi te themeloje Shoqërinë me Përgjegjësi te Kufizuar "Source Albanian" shpk dhe vendosi te aprovoje këtë Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqërisë sipas termave dhe kushteve te mëposhtme:

TITULLI 1

EMERI I SHOQERISE – REGJIMI JURIDIKE – SELIA – KOHEZGJATJA

Neni 1

Emeri i Shoqërisë

- 1.1 Ne përputhje me legjislacionin shqiptar, është krijuar Shoqëria "Source Albania" shpk ne vijime referuar si "Shoqëria".
- 1.2 Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.
- 1.3 Email: sourcealbania@gmail.com

Neni 2

Regjimi Juridik I Shoqërisë

- 2.1 "Source Albania" shpk është një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar.
- 2.2 Aktiviteti I saj është I organizuar sipas dispozitave te aktiti te Themelimit , Statusit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtinë dhe legjislacionin civil ne Republikën e Shqipërisë.
- 2.3 Me vendim te Asamblesë se Përgjithshme, Shoqëria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e Statusit te saj.
- 2.4 Shoqëria fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjimin Tregtare.

Neni 3

Selia

- 3.1 Shoqëria sa selinë e saj ne adresën: Kompleksi "Laguna Blu" Qerret, Kavaje, Tirane
- 3.2 Shoqëria mund te hape ose te mbylle dege , filiale dhe / ose zyra përfaqësimi Brenda Shqipërisë dhe / ose jashtë vendit, ose te krijojë shoqëri te tjera me Partnere apo Aksionarë pjesëmarrës.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjimin Tregtar. Ortaku/et e Shoqërisë mund të vendosin të kufizojnë kohëzgjatjen e aktivitetit me një vendim Asamblesë së Përgjithshme.

TITULLI 2

OBJEKTI

Neni 5

Objekti

5.1 Objekti kryesor i Shoqërisë do të përfshijë po nuk do të kufizohet vetëm në veprimtaritë e mëposhtme:

Ofrimi i shërbimeve dhe konsulencave profesionale në fushën ekonomike. Ofrimi i shërbimeve dhe konsulencave profesionale në fushën e marketingut dhe Publik Relationship (PR). Ofrimi i 2 shërbimeve dhe konsulencave profesionale në fushën e marketingut dhe Publik Relationship (PR). Ofrimin e shërbimit një qendër për praktiken e këshillimit për studente universitar, si dhe një qendër e kërkimit shkencor në çdo fushë. Konsulencë dhe asistencë në menaxhim projektesh në fusha të ndryshme të jetës sociale. Aktivitete të ndryshme në fushën e Real Estate. Ndërmjetësim në konflikte/kontradikta të sipërmarrjeve dhe/ose individëve me natyrë ekonomike. Analiza të detajuara të gjendjes ekonomike dhe raportimi në formën e due diligence. Ofrimi i shërbimeve dhe konsulencave profesionale në fushën e teknologjisë së Informacionit: Institucioneve publike dhe private, organizatave, SME-ve dhe kujtdo që ka nevojë për konsulencë apo për një produkt konkret në fushën e teknologjisë së informacionit. IT Consulting, IT Solutions IT Consulting Services IT Outsourcing, Web solutions, Websites, web applications, e-commerces, mobile solutions, SEOs, Back-end Systems. Konsulencë në fushën e menaxhimit, të marketingut, marrëdhënies me publikun, lobimin për palë të treta dhe të ngritjes së sistemeve të cilësisë sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare (ISO dhe të tjera) për të gjitha llojet e organizatave, shoqërive tregtare dhe institucioneve publike. Realizimin e studimeve dhe projekteve për organizata biznesi, për institucione publike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për organizata jofitimpruese. Realizimin e trajnimeve profesionale për persona fizik dhe juridik apo institucione. Organizimin e eventeve të biznesit, krijimin dhe forcimin e imazhit të kompanive. Menaxhimin e krizave ose katastrofave të kompanive të tregtisë. Tregtim me shumicë e pakicë të mallrave industriale dhe ndërtimore, xhamave të të gjitha llojeve, pasqyrave, durave të punuar, durave të aluminit, drurit, hekurit, plastikave...etj. Veprimtari ekonomike-juridike në fushën e energjitikës, duke përcaktuar por pa kufizuar veprimet e përmendura: krijimi i sistemeve elektroenergjitike, prodhimin import-eksport të energjisë elektrike me të gjitha format që njihë teknologjia dhe sidomos të energjisë nga burime të rinovueshme, duke përmendur vecanërisht sistemet me panele diellore termike dhe fotovoltaike si edhe sistemet e edlike (të ertes). Shit-blerjen e energjisë elektrike tek operatorët lokal apo ndërkombëtar, sipas legjislacionit dhe lejeve të organeve kompetente. Ndërtim projektim dhe zbatim të të gjitha linjave elektrike, interkonjeksionit për transmetimin e energjisë elektrike. Prodhimin vendas dhe shitjen/shkëmbimin e energjisë elektrike, për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm dhe me kosto të ulët për klientet tarifore paralelisht me venien në punë të burimeve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese. Si dhe të kryejë/krijojë/veprojë për realizuar të gjitha veprimet juridike, si pas përkufizimeve ligjore, të përcaktuara në ligjet për energjinë elektrike dhe ato të burimeve të rinovueshme të energjisë. Tregtimin e Energjisë Elektrike (1)2514). Prodhimin e Energjisë Elektrike (D3511). Transmetimin e Energjisë Elektrike (D3512). Tregtimin me shumicë e pakicë, import-eksport të mallrave dhe materiale të ndryshme industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, makineri e pajisje të ndryshme, pajisje ndërtimi, etj., pajisje elektrike edhe elektronike, pajisje hidraulike, hidrosanitare, elektrike, materiale ndërtimi, mallra të të gjitha llojeve. Auditime dhe konsulencë trajnime të fushës së ekonomisë, marketing, universitare dhe mediatike.

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji, i zbatueshëm, në Republikën e Shqipërisë.

TITULLI 3

KAPITALI I SHOQERISE – TRANSFERIMI I KUOTAVE – ZMADHIMI I KAPITALIT

Neni 6

Kapitali I Shoqërisë

6.1 Kapitali I shoqërisë është me vlerën 100 (njëqind) I ndare 1 (një) kuote.

Kapitali I shoqërisë do te paguhet plotësisht nga ortakut/et themelues si vijon:

a) **Z. Baton Haxhiu**, nënshkruesi I 1 (një) Kuote e barabitë me **100%** te kapitalit te shoqërisë, me një vlere prej 100 Lek (njeqind);

6.2 Përgjegjësia e Ortakut/et ndaj palëve te treta për detyrimet e marra përsipër nga kompania është e kufizuar sipas pjesëmarrjes se ortakut ne kapitalin e shoqërisë.

Neni 7

Transferimi I Kuotave

7.1 Transferimi I kuotave te shoqërisë ndaj palëve te terat I nënshtrohet se drejtës se parablerjes ne favore te ortakeve te tjerë te viler mund te ushtrojnë ketë te drejte sipas kushteve te përcaktuara ne nenin 7.2 dhe 7.6 me poshtë:

7.2 Ne rast se një ortak “Ofruesi” kërkon te shesë dhe/ose te transferoje disa ose te gjitha kuotat e tij, ortakët e mbetur (“Ortakët e mbetur”) do te kenë te drejtën e parablerjes ne lidhje me kuaten qe ofrohen për transferim (“Kuota e ofruar”) sipas kushteve te mëposhtme:

a) Ofruesi do tu dërgoje fillimit ortakeve te mbetur një njoftim me shkrimi I cili përcakton përqindjen e kuotës se ofruar, çmimin dhe kushtet e tjera te transferimit te cilat duke te përshijnë Identitetin e Blerësit (“OFERTA”),duke ftuar se pari Ortakët e mbetur te blejnë aksionet e ofruara;

b) Ortakët e mbetur do te ketë te drejtën te blejnë kuotat e ofruara përpjesëtimisht dhe sipas kushteve te ofertës, duke I dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një afati një tridhjete (30) ditësh pas marrjes se njoftimit te Ofruesit.

7.3 Ne rast se me shume se një prej Ortakeve te mbetur dëshirojnë te blejnë kuotat e ofertuar, secili prej tyre k atë drejtën te blejë kuotën ne ofruar përpjesëtimisht sipas përqindjeve qe zotërojnë ne Shoqëri, duke I dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati nje tridhjete (30) ditësh pas marrjes se njoftimit sipas se cilit secili prej tyre dëshiron te blej kuotën ne oferte.

7.4 Ne rast se asnjë nga ortakët e mbetur nuk dëshiron te blejë kuotën e ofruar dhe/ose kane refuzuar te blejnë kuotën e ofruar, sipas kushteve te përcaktuara këtu, Brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, Ofruesi do te ketë te drejte te transferoje kuotat e ofrua një pale te trete me te njëjtin çmim qe I është ofruar ortakeve te mbetur (sipas kushteve te ofertës fillestare). Nëse ku kusht nuk është përmbushur, Marrëveshja për shtijën e kuotave me pale te terat do te jete e pavlefshme.

7.5 Ne raste se ndonjë ose te gjithë ortakët e shoqërisë blen/blejnë kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertës, siç përcaktohet me sipër, ky transferim do te kryhet sipas kushteve te ofertës.

7.6 Kushtet e parashikuara me sipër nuk do të zbatohen në rast transferimi të kuotave nga një ortak tek një shoqëri e cila ndodhet nën kontrollin e këtij ortaku ose në rast transferimi nga një ortak tek një paraardhës ose pasardhës i drejtpërdrejtë i tij ose tek bashkëshortit/es.

7.7 Dispozitat e nenëve 7.1-7.6 nuk do të zbatohen në rast transferimi të bere në favor të ortave të tjerë. Megjithatë, në këtë rast transferimi duhet të komunikohet fillimisht me shkrim edhe ortakeve të tjetër. Te gjithë njoftimet sipas këtij neni duhet të dërgohen edhe Shoqërisë.

Neni 8

Rritja e Kapitalit

8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë kapitalin e shoqërisë në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare.

8.2 Në rast të rritjes së kapitalit ortakët kanë të drejtë të nënshkrimit të kuotave nëpërmjet kontributit në natyrën ose në të hollë në proporcion me përqindjen e gëzojnë në kapitalin e shoqërisë.

8.3 Nëse ndonjë nga ortakët refuzojë të drejtën e nënshkrimit kapitali mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, ortakët e tjerë mund të ushtojë të drejtën e tyre për nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, ortakët e tjerë mund të ushtojnë të drejtën e tyre për nënshkrimit të kapitalit në proporcion me përqindjen që gëzojnë në kapitalin e shoqërisë.

Neni 9

Zvogëlimi i Kapitalit

9.1 Asambleja e përgjithme mund të zvogëlojë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Në çdo rast, kapitali nuk mund të reduktohet nën vlerën minimale të përcaktuar me ligj.

9.2 Ortakët përballen me uljen e kapitalit të shoqërisë në proporcion me kuotat që zotërojnë secili prej tyre.

Neni 10

Certifikata e pjesëmarrjes

10.1 Secili prej ortakeve gëzon të drejtën e një certifikatë në lidhje me përqindje e pjesë që gëzojnë në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë me shume se një certifikatë për kuotat e mbajtura së bashku me disa ortake dhe shpërndarja e certifikatës për përfaqësuesit e përbashkët e anëtareve do të konsiderohet e dhënë me interes të të gjithëve ortakeve në përputhje me dispozitat ligjore.

TITULLI 4

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 11

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statusit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statusi duhet depozitohet pranë QKB për të pasqyruar

ndryshime ne skedën e shoqërisë.

Asambleja vendos për çështje si:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emërimin e shkarkimin I likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administrator ku përfshihet te gjitha
- f) Përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedime te tjera ndaj administrove
- g) Miratimin e rregullave proceduralë ne mbledhë te asamblesë

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku/et regjistrohen ne një regjistër te vendimeve, te dhëne e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet mbi ecurinë
- b) Shpërndarjen e fitimit vjetor dhe mbulimin e humbjeve
- c) Investime
- d) Vendime për riorganizim ose prishjen e shoqërisë

Neni 12

Administratori

Administrator I shoqërisë është **znj.Besa Kopellaj** lindur ne Tirane 19.08.1990 me ID **J05819064F**

Administratori I shoqërisë do te ushtojte kompetencat e administratorit për një afat **5 vjeçar** me te drejtën e ripërtëritje duke filluar nga data e këtij statuti.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakeve te shoqërisë.

Administratori I shoqërisë mund te emërohet edhe një person I trete jashtë ortakërisë.

Neni 13

Kompetencat

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

- a) Kryejnë te gjitha veprimet e administrimit te zakonshme dhe te jashtëzakonshëm te veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaku I vetëm;
- b) Përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë;
- d) Përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë se veprimtarisë dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve I paraqesin këto dokumente përpara ortakut te vetëm për miratim;
- e) Kryen regjistrime dhe dërgon te dhënat e detyrueshme te shoqërisë siç parashikon ligji për QKB
- f) Raportojnë përpara asamblesë se përgjithshme.

Administratori ka te drejte:

- a) Te thërrasë mbledhje te asamblesë
- b) Te përfaqësoj shoqërinë ne Banka

- c) Te nënshkruaj nen emër te shoqërisë
- d) Lejohet te delegoje kompetencat e tij nëpërmjet një prokurë Nateriale.

TITULLI 5

VITI FINANCIAR – DIVIDENTI

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar I Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci I shoqërisë dhe Dividenti

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakërisë miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. Mbledhja e Ortakërisë vendos rreth shpërndarës se dividendit, Pasi te jene zbritur humbjet e vitit te mëparshme financiar, siç edhe e parashikon ligji.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka te drejte te kontrolloje te gjithë dokumentacioni kontabël te veprimtarisë ekonomike tregtarë te shoqërisë. Në përfundim te kontrollit ekspertizën e tij e ka për detyre ta lëshoj ne forme te shkuar.

Neni 17

Dividenti

Te ardhurat neto (Divident) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mësipërme dhe te atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te tretave I mbeten dhe I kalojnë ne pronësi ortkut/vet e shoqërisë.

TITULLI 6

SHPERBERJA-NDARJA – BASHKIMI –LIKUJDIMI

Neni 19

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikimit te themelimit te tij
- b) Me vendim te oratak/ve
- c) Me hapje e procedurave te falimentimit
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari për dy vite dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë ne përputhje me piken 3 neni 43 te ligjit nr.9723 date 3.05.2007 per QKb
- e) Me vendim te gjykatës

Likuidimi kryhet nga personi i autorizuar te emëruar nga Ortakëria. Nëse Ortaku/et nuk merret një emërimin e likuidimeve Brenda 30 dite pas prishjes, çdo person i interesuar mund te drejtohet ne gjykate për te përcaktuat likuiduesin.

Neni 20

Likuiduesi/t merr përsipër te drejtën dhe detyrat për likuidimet e administrativeve nga data e emërimit te tij. Janë te mbikëqyrur nga ortakët dhe administratoret.

Neni 21

Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

- a) Te mbylle te gjitha veprimtarit e shoqërisë, kredive te pa arkëtuara e kontribute te pashlyera, shitja e pasurive dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar rrodhen sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- b) Mund te krye edhe veprime te reja tregtarë për mbyllje te papërfunduara
- c) Ne raste padive, përveç likuidimeve duhet edhe pezullimi dhe njoftimi i shkrim. Gjithashtu duket raportuar ne bilancin e kompanisë.

Neni 22

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes se aktiveve te mbetura likuiduesi e njofton QKB për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë ne përputhje me seksionin V te ligjit 9723 te 03.05.2007 “për QKB”

Neni 23

Bashkimi

Dy ose me shume shoqëri mund te bashkohen nëpërmjet:

- a) Kalimin e te gjitha aktiviteteve pasivë – Shoqëri me përthithje te jete shoqërie ekzistuese, ne këmbim te aksioneve apo kuotave.
- b) Themelimin e një shoqërie te re tek e cila kalon te gjitha aktivitete pasive te shoqërisë ekzistuese dhe bashkon ne këmbim te aksioneve apo kuotave te shoqërisë se re – Krijimi i shoqërisë se re.

Neni 24

Ndarja

- Ndarje mund te quhet te gjitha zërat e nenit 23 pika a dhe b te këtij akti themelues.
- Zbatimi i dispozitës neneve 216 deri 225 te ligjit 9901 dt 14.04.2008

Neni 25

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshoje formën e vete ligjore, nëpërmjet shndërrimit te tije ne shoqëri aksionarë. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrime qe shoqëria ka marr përsipër ndaj te tretave.

TITULLI 7

NDRYSHME

Neni 26

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe si dispozitat e legjislationit shqiptarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohet dispozita e ligjit “Për tregtarët dhe për shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik të Republikës së Shqipërisë.

Neni 27


Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj statute, si edhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretave, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

THEMELUES

ORTAK

Z.BATON HAXHIU

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Baton Haxhiu', written over the printed name.